

AMINA IMERI

**BOTA
IME E VOGËL**

Zhelinë, 2025

Amina Imeri
Bota ime e vogël

Autori- *Amina Imeri*

Titulli- *Bota ime e vogël*

Redaktor- *Muaxher Haruni*

Recensent- *Merita Isaki*

Lektor- *Muaxher Haruni*

Dizajni- *Emin Haruni*

E PAHARUAR GJITHMONË

Më prisje në karrigen tënde të vjetër
Me një buzëqeshje që shëron çdo lodhje,
Me një përqaftim që më mbushte shpirtin
Dhe me fjalë që më bënë të ndihem e sigurtë.

Ndonjëherë kur kthehem nga shkolla
Ti je aty, ulur në karrigen tende me duar t'hapura,
Vrapoj dhe të përqafoj fort,
Sillem sikur s'je larguar aspak..

Pastaj, papritmas hap sytë...
Shikoj rreth e rrotull...
"Ishte vetëm një ëndërr"..
Kjo fjali ri ende në gojën time..

Lot, lot dhe vetëm lot..
Mendon se ndonjëherë mund të kthehesh,
A ekziston një mundësi e tillë
Apo do duhet të vuaj gjithmonë kështu?

Për Gjyshen time, që është diku
Atje, lartë lartë në qiell....

LIBRI, BURIM I DIJES

Një libër hap dhe bota zbardh
Një dritë në zemër nis të ndrit,
Si yll në errësire ai shëndrit
Dhe shpirtit krahë të reja i fal.

Në faqe fjalët marrin jetë
Tregojnë histori pa fund,
Na çojnë larg, në çdo sekond
Nga ëndrrat tona bëhen shteg.

Një libër flet me zë të butë
Si miku yt më i vërtetë,
Në çaste malli e të qetë
Të rrefen botë krejt pa frikë.

Në të gjen zemrën e njeriut
Gëzim, trishtim dhe fshehtësi,
Një mendimtar, një fjalë magji
Një ëndërr ndritur nga shkrimi.

O libër, thesar i madh në jetë
Si dielli ndriçon mendjen tonë,
Na mëson rrugën e vërtetë
Dhe na le gjurmë në çdo kohë.

KUSH JAM “UNË”

Një ditë dikush mu afrohu dhe me pyeti:

“Më do?”

Sa pyetje e bukur!

Me të vërtetë!

Për fat të keq, unë nuk kisha përgjigje..

Kështu ata u larguan..

E dija se kisha bërë gjënë e duhur..

Nuk mund të duash dikë në qoftë se nuk e don veten...

Në fakt çështja e duhur është:

“Si mund të duash dikë që nuk e njeh?”

Ende se kam kuptuar kush është “UNË”

Ka ditë që vë në dyshim ekzistencën time,

Dhe shpesh lëndohem emocionalisht..

Ka dhe ditë që ndihem si personazhi kryesor, sigurisht..

Ndonjëherë mendoj se ndoshta “Unë” nuk kërkohet..

Ndoshta jam unë ajo copeza që e plotësoj këtë “Unë”..

Ndoshta jam “Unë” ajo që e plotëson këtë “Unë”

Ndoshta “Uni” nuk duhet kërkohet, ndoshta duhet krijuar.

NËNA - ËNGJËLLI I IM I HESHTUR

Shtëpia merr jetë kur Ajo buzëqesh
Çdo hap i saj është bekim i heshtur,
Nuk i duhet zëri i lartë për t'më mësuar
Më mëson me zemër, më rrit me kujdes.

Nëna ime është si dielli në re
Ndoshta nuk dallohet gjithmonë,
Por është aty,
Më mbron pa u dukur, më do pa kushte
Është forca ime, ëndrra ime e bukur.

Në sytë e Asaj ka një dritë të qetë
Si një detë pa dallgë, që gjithmonë më pret,
Në përqaftimin e saj ka paqe dhe ngrohtësi
Si stina e pranverës që kurrë nuk ikën.

Se them shpesh, por ndoshta duhet më shpesh
Pa të, jeta ime do ishte bosh,
Ajo është zemra që rreh për ne
Nëna ime, dashuria që s'ndryshket kurrë.

SA SHUMË RRUGË, PLOT ZGJIDHJE

Ndjehem sikur gjithkush i ka sytë tek unë,
Sikur gjithkush mund të dëgjoj zërin tim të brendshëm,
Në shpirt s'kam paqe, asnjë punë,
Sa shumë rrugë, plot zgjedhje.

Jam mes ëndrrave që s'kanë kufi,
Mes pyetjeve pa përgjigje, njeri,
Ndjej botë të madhe, veten të vogël,
Sa shumë rrugë, plot zgjedhje.

Kur isha e vogël besoja,
Se e keqja s'ishte gjëkund,
Veç njerëz që kishin humbur,
Pa një dritë, pa një udhë.

Po tani që jam rritur,
E kuptoj se bota vuan,
Disa lindin për të ndritur,
Disa zhyten në errësirë.

NATYRA, QETËSIA E SHPIRTIT

(Dua të jem e lirë)

Dikur mes gjelbërimit
Ku era fryn ngadalë dhe qetë,
Aroma e luleve të sapoçelura
Të më gjallërojnë si një prekje fëmije.

E gjej veten të humbur në mrekullitë e natyrës
Teksa mbyll sytë dhe ndiej diellin e ngrohtë,
Cicërimat e zogjve që më flasin më gjuhë qiellore
Degët përkulen me përuhtësi përmbi mua.

Çdo rreze dielli më përqafton me butësi
Çdo fllad më fton në një vallëzim të heshtur,
Te jem njësh me tokën, ajrin, me dritën
Larg çdo zhurme, çdo mendimi që më rëndon.

Në atë çast ndalem, asgjë s'më mungon
Çdo gjë rreth meje merr kuptim të thellë,
Në heshtjen që flet me shumë se mijë fjalë
E shpirti im më në fund gjenë strehë.

ËNDRRAT NDRYSHOJNË

Në duart e vogla mbaja ëndrra të mëdha,
Një mantel i bardhë, një buzëqeshje shprese,
E besoja se bota do shërohej,
Vetëm nga prekja ime e butë.

Por koha kaloi..
Dhe zemra ime nisi të fliste ndryshe,
Nuk jam më ajo vajzë e vogël
Që shihte vetëm një rrugë drejtë dritës.

Tani më ndjekin pyetje të heshtura
A dua të shëroj trupin, apo shpirtin?
A dua të luftoj për të drejten,
Apo të dëgjoj zerrat që askush nuk i dëgjon?

Ëndrrat e mia kan marr krahë,
Nuk janë më të lidhura në një ëndërr të vetme.
Fluturojnë lartë, prekin degë të ndryshme,
Dhe me thërrasin të zgjedh pa ngutje.

KATËR PËSHPËRIMA

Pranvera, stina kur mora frymë,
Me lule që qeshin nën diellin e ngrohtë,
Na flet me pëshpërim në çdo rrymë:
“Pas dimrit të ftohtë, vjen paqja e plotë”

Kur vjen vera, gjithçka merr ngjyrë,
Ndiej një qeteësi të papërshkrueshme,
Ngre kokën lartë, mbyll sytë pa frikë,
Dhe zemra më rreh me ritmin e zemrës së lirë.

Nën psherëtimen e oxhakut të vjetër,
Mbështjellur me aromën e qumshtit të ngrohtë,
Shikoj si gjethet shtrihen mbi tokën e lagur,
Teksa shiu fshin ngadalë ngjyrat e fundit.

Në fushat e bardha hesht dimri i lehtë
Flokët e borës bien si përralla në ajër,
Fëmijët lënë gjurmë mbi shtresat e buta
E dita zbardh nën një qiell të qetë.

ATO FLASIN, UNË JO

Ato flasin sikur të ishte një sport
Pëshpëritje të mprehta si thika,
Duke prerë heshtjen time
Sikur u detyrohem atyre pjesë të jetës sime.

Ato thonë emrin tim me të qeshur
Shaka pas shpine,
Më shumë kur kaloj-
E vërteta e varrosur në aktin e tyre.

I kaloj historitë e tyre
Buzëqesh sikur nuk dëgjoj,
Por fjalët që fluturojnë për rreth
Ende tingëllojnë me zë të lartë në veshet e mi.

Kjo nuk është shkollë e mesme e vogël
Është helm me një buzëqeshje,
Një brez me gojë të zhurmshme
Dhe zemrat të holla si letra.

Mund të bërtas, mund të therras,
Por pse të ushqej lojën e tyre?
Pse tu kushtoj vëmendje,
Njerëzve që nuk ndryshojnë jetën?

Kështu unë e mbaj volumin të ulët
Injoruj ato që rrotullojnë,
Fjalët e tyre nuk më përcaktojnë mua-
Ata vetëm i bëjnë jehonë mekatit të tyre.

Ju e quani atë “thjeshtë duke folur”,
Por është mizore në maskim
Nëse shikoni pak më afër,
Do shihni të vërtetën në syte e mi.

KUR GABOJ

S'jam perfekte, shpesh bëj gabime,
Por prindërit më flasin me fjalë të ndritshme.
S'më qortojnë ashpër, më mësojnë me butësi,
Të kuptoj ku gabova dhe të jem më mirë çdo ditë.

Më thonë: “Gabimi është mësim në jetë,
E rëndësishme është ta pranojmë me drejtë.”
Unë i dëgjoj dhe mundohem fortë,
Të rritem me nder, me mendje e me zot.

Dhe kur më duket se rruga më humbet,
Një këshillë e tyre zemrën ma ndriçon vet.
Më japin forcë të ngrihem sërish,
Të mos dorëzohem, të bëhem më e mirë çdo ditë, pa fish.

Se jeta s'është veç suksese e lavdi,
Por rrugë me pengesa që duhen kaluar me dashuri.
Me familjen pranë, çdo gabim është leksion,
Një hap drejt rritjes, një hap drejt përmirësim me emocion.

MËSUESJA IME, DRITA DHE POEZIA

Që nga klasa e parë s'kisha ndonjë të veçantë,
Të tjerët thoshin emra, dhe unë i dëgjoja në heshtje pranë.
“Mjafton të na mësojë mirë” – mendoja në shpirt,
S'kishte rëndësi kush, për sa kohë kishte dritë.

Por pastaj erdhi ajo – Mësuesja e Shqipes,
E ëmbël në fjalë, e thellë në shikime.
Që në ditën e parë, kur u njohëm me sy,
Fjalët e saj më lanë gjurmë në shpirtin tim të ri.

Më foli për ditën e librit, për një konkurs të veçantë,
“Një poezi shkruaj,” tha, “me zemër, jo me fjalë të thata.”
S'e kisha pasion, veç ndonjë varg i thjeshtë,
Por ajo më dha besim - dhe tani s'jam më e njëjta.

Çdo ditë shkruaj, çdo ndjesi e kthej në varg,
Dhe fjala s'më tremb më, por më bëhet shpëtimtar.
Dua të botoj një libër, ëndërr që tani s'është e largët,
Dhe kjo ndodhi sepse ju, mësuesja ime, më patët parë
ndryshe nga tjerat.

Tani jam rritur pak, e mund të zgjedh vetë,
Se kush më ka ndihmuar të bëhem kjo që jam në jetë.
Dhe unë pa dyshim e them me zë të lartë:
Ju jeni mësuesja ime e preferuar, nga zemra,
Nga e ardhmja, nga çdo fjalë!

Dhe pse vetëm pak muaj më ndajnë nga kjo klasë,
Kur të jem në gjimnaz, s'do jeni më në orën pas.
Por unë s'do harroj, kurrë nuk do fshij,
Kujtimet që kam me ju, do i mbaj si poezi.

Nëse ndonjëherë lexoni vargjet e mia diku,
Dijeni: aty jeni ju.
Mes rreshtave të ndjenjës, mes fjalëve të mia,
Rri e përjetshme: Mësuesja ime, drita dhe poezia.

DITARI IM SEKRET

Një fletore me kopertinë blu,
Mbaj brenda ndjenja që nuk i them askujt.
Shkruaj për ëndrrat, dyshime dhe shpresë,
Një botë e imja, pa zhurmë, pa stres.

Në çdo faqe rrëfej me kujdes,
Fjalë që s'i shqiptoj dot me zë nën dritë.
Një botë e fshehur mes rreshtash të shkruar,
Ku zemra flet lirë, pa frikë e pa mur.

Kur nata bie dhe bota hesht,
Unë zgjahem brenda me një mendim të thjesht.
Në kopertinën blu e gjej ngushëllim,
Në fjalë të mia, gjej shpëtim.

BABI IM, HEROI IM

Më tha: “Mos ec pa ditur ku shkon,
Njerëzit s’të ndjekin gjithmonë.”
Fjalët e tij më rrinë si dritë,
Në rrugën time çdo ditë e çdo natë.

Kur shpirti më thyhet, kur qaj pa zë,
Ai vjen pranë me duar plot ngrohtësi dhe besë.
Me një përqafim më kthen në jetë,
Si magji që shëron gjithçka përmbi vetë.

Nuk lejon që askush të më lëndojë,
Bëhet mal para meje, me zemër që s’të gënjen.
Në sytë e tij gjej paqe dhe fuqi,
Si yll që ndriçon veç për dashuri.

Ai nuk ka pendë, por është engjëll për mua,
Fjalët e tij më mësojnë si të dua.
Kur bie, ai më ngre pa u lodhur kurrë,
Në çdo stuhi, është streha ime e sigurtë.

Më mbron me zë të butë, por me shpirt luftëtar,
Më sheh si princeshë, por më rrit si një grua me karakter të
ndarë.
Babi im, hero i heshtur i ditëve të mia,
Ti je forca, ti je dashuria.

ADOLESHENCA

Mosha më e ngatërruar,
Mosha më marramendëse,
Adoleshenca - si zemër që rreh fort,
Një stuhi e brendshme, një botë e mendimeve të shpeshta.

Adoleshenca - adrenalina në një frymë,
Por edhe heshtja që mbërthen në shpirt pa zë.
Ëndrra që digjen, pastaj rilindin më të mëdha,
Si feniksi që ngrihet nga hiri i veta.

Një ditë ndihesh si mbretëreshë e botës,
Të nesërmen, e vogël si grimë në erësirë.
Por pikërisht aty fillon rritja e vërtetë:
Kur mes kaosit, mban shpresën në dorë si dritë.

Thonë që njerëzit vdesin në adoleshencë,
Por varrosen më vonë – sepse ndalojnë së jetuari.
Por unë nuk dua të vdes brenda heshtjes,
Unë dua të digjem nga drita e të jetuarit.

Do gabo, do bie, do qaj - e prapë do ngrihem,
Sepse ky është kuptimi: jo të jesh e përsosur, por e gjallë.
Adoleshenca s'është fundi, është fillimi i udhës,
Një rrugë që më mëson si të jem unë- me zemër dhe guxim.

Nuk jemi më në kohën e gurit
Gruaja s'është veç një emër i thjeshtë,
Ajo mban botën në shpirtin e hesht.
Me fjalë të buta ndërton një shtëpi,
Me zemër të fortë përball çdo stuhi.

Ajo qesh, ajo qan, dhe s'ka turp nga kjo,
Se ndjenja është fuqi, jo një gjë për t'u fshehë.
Ajo fal pa masë, dhe mban më shumë,
Edhe kur nuk flet, në heshtje ka zhurmë.

Ka duar të vogla, por zemër të madhe,
Punon pa u lodhur në ditë e në natë.
Mendon për të gjithë, por veten e lë,
Se dashurinë e ka rrënjë në shpirtin e saj të thellë.

Ajo është nënë, edhe kur s'ka fëmijë,
Se kur dikush thërret "nënë", ajo kthehet me sy.
Ka ndjesi të thella që s'i trembin aspak,
Se ajo e di që forca s'matët me gjak.

Ndonjëherë është lart, më lart se një burrë,
Jo nga pushteti, por nga durimi që s'ka mur.
Ajo mbështet, ndërton, dhe s'ka nevojë për lavdi,
Se ajo e di vlerën pa zhurmë, me thjeshtësi.

Gruaja është botë, është dritë dhe është zjarr,
Është fillimi i çdo gjëje, është rrënjë e çdo far'.
Nuk jemi më në kohën e gurit të rëndë,
Gruaja s'është hije - ajo është zemra që rreh në çdo vend.

LAMTUMIRË ME ZË TË DRIDHUR, POR ME ZEMËR TË FORTË

“Lamtumirë me zë të dridhur,
por me zemër të fortë”
Sot nuk flas si ajo vajza që dikur heshti,
por si dikush që rriti zërin,
edhe kur e ndjeu veten në peshqir të ngjeshur.
Me fjalët që ndoshta s’janë perfekte,
por vijnë nga shpirti im i vërtetë,
po ju them lamtumirë - jo me inat,
por me dashuri dhe respekt.

Kisha plot emocione kur shkrova këtë letër,
ende më dridhen duart,
edhe pse di që jam më e vjetër.
E ndjej si më rreh zemra kur e lexoj çdo varg,
por kjo është forca ime të flas edhe kur më duket larg.

Këto banka më panë të rritem,
të qesh, të gaboj,
të mbledh veten kur rrëzohesha,
të ngrihem e të mësoj.
Mësues që më falën dije,
e ndonjëherë edhe durim,
na pritën çdo mëngjes me përkushtim
dhe shpirt njerëzor, pa dyshim.

Shoqëri të çmuara kam gjetur në këtë vend,
që më bënë të ndihem mirë,
pa më ndryshuar asnjë send.
Fjalët tona, të qeshurat,
përqaqimet pas ndonjë dite të vështirë,
do i mbaj në zemër si kujtime
që kurrë nuk shuhen,
kurrë s'harrohen pa mëshirë.

Sigurisht, kishte ditë kur nuk ishte aq lehtë,
disa më bënë të ndihesha si hije, jo si vërtetë.
Por tani unë nuk flas për ta që më lanë në terr,
flas për dritën që gjeta brenda vetes,
kur askush nuk e pa më parë aq qartë.

Po largohem, por jo si dikur - me zemër të ngatërruar,
po largohem si vajza që ka mësuar të ecë,
pa pasur frikë të jetë e guximtare.
Sepse kjo është rritja:
jo vetëm nota në letër,
por të dish të dashurosh veten,
edhe kur ndihesh pak më e brishtë se tjetri.

Shkolla e mesme më pret –
një botë më e madhe, një sfidë,
por nuk jam më e vogël.
Jam gati të fluturoj pa frikë.
Me shoqet e mia përkrah,
kujtime që s'më tradhtojnë,
dhe ëndrra që s'i kam harruar,
por tani dua t'i provoj.

Lamtumirë, shkollë që më dhe fillimet e para,
lamtumirë, e dashur
dhe ndonjëherë e ashpër si nënë
që s'të lë të biesh në rrugë të ndara.
Unë po iki sot, po nuk harroj asgjë nga ty -
as çastet, as njerëzit,
as veten që rrita ngadalë nën këtë çati.

Dhe nëse më dridhet zëri,
mos më gjykoni fare,
se janë emocionet e një rruge
që mbyllet me kujdes e me mall që s'ka fjalë.
Po e lexoj këtë me duar që ende dridhen pak,
por me një zemër që tani nuk ka më frikë nga asgjë
- as nga hapat e parë, as nga zërat që nuk flak.

NË HESTJEN E LUTJES

Thonë: “Mos u frikëso, është kalimtare,”
por unë ndiej diçka më shumë se fjalët.
Ka netë që lutja më del vetë nga shpirti,
si një psherëtimë që kërkon qiellin,
pa zë, pa fjalë... vetëm zemër.

Zëri i tij më ngjan me diellin në perëndim -
i ngrohtë, por me një hije që zgjatet.
Ai thotë: “Jam mirë,” dhe unë tund kokën,
por thellë në mua, një valë e heshtur flet ndryshe.

S’jam vetëm me frikën time,
Ajo ulet pranë meje si një engjëll pa emër.
Duke më kujtuar se dhimbja nuk është fundi,
por një derë që hapet drejt një drite të panjohur.

Në çdo fjalë që shkruaj, ndizet një qiri,
jo për ta ndriçuar botën,
por për të mos humbur rrugën në shpirtin tim.

Dhe kur sytë më mbushen me dyshim
mbyll sytë dhe e dorëzoj gjithçka,
atë që di, atë që nuk di
tek Ai që sheh edhe kur s’flitet.

Sepse ndonjëherë, forca nuk është të mos qash,
por të dish se lotët mund të bëhen lutje.
E unë lutem... pa zë, pa fjalë...
vetëm me frymën e një zemre që shpreson.

FJALËT TUAJA JANË PLUMBA

“Ajo vet e kërkoi.”

-thua ti, burrë me emër të zbrazët,
si të mos kishte dhimbje,
si të mos kishte gjak në shtrat.

“E pe si ishte veshur?” –

thua, me gojë që pikon vrer,
si të ishte faji i saj që ti s’e njeh
kufirin e ndershmërisë njerëzore.

Një fund i shkurtër
s’të jep leje për të shqyer,
një buzëqeshje
s’të jep të drejtë për të thyer.

Gratë nuk janë ftesa
- janë njerëz, janë jetë,
jo trofe për egon tënde
që zvarritet si gjarpër nën pet.

Ti tallesh,
bën shaka me përdhunimin -
por ç’është humor
kur tjetri vuan si krimin?

Çfarë burri je
kur dhimbjen e bën për lojë,
kur vajzat thërrasin ndihmë
e ti qesh në qoshe, nën zë.

Fjalët e tua janë plumba
që vrasin ngadalë,
ato mbajnë gjallë frikën,
e veshin me fjalë.

Kur thua “ajo s’duhet të dilte natën,”
po ia var fajin viktimës,
jo bishës që s’njeh ndaljen.

Ti s’mund ta quash veten burrë, jo,
sepse burri nuk kafshon, nuk dhunon,
nuk përdor frikën për forcë.

Burri i vërtetë nuk flet për të me neveri,
por e mbron, e nderon,
ia ngre zërin kur s’mund të flasë.

Shikoje nënën tënde.
Shikoje motrën.
Do doje t’u flisnin siç flet ti për to
në errësirën e zhurmshme të burrërisë false?

Jo, nuk është ajo që e kërkoi.
Ti ishe ai që zgjodhe të mos jesh njeri.

TË DUA SHKOLLË, QË MË DHE EMËR (Poezi për Festën e shkollës sime)

Nuk e mbaj mend ditën e parë siç duhet...
vetëm di që isha e vogël, e hutuar,
dora ime e vogël shtrëngonte çantën,
zemra ime - një dru i njomë
që nuk dinte si të qëndronte drejt.

Por ti, shkollë, më prite me dashuri.
që atëherë e deri sot,
rrita hapat në korridoret e tua,
rrita zërin në orët ku më mësove të flas,
rrita vetveten - pa e kuptuar, ngadalë, çdo ditë.

Ti nuk ishe thjeshtë shkollë
ti ishe vendi ku mësova të qesh
edhe kur më vinte të qaja,
ku mësova se gabimet nuk janë turp,
por prova që po rritem.

S'dua të veçoj asnjë mësuese, asnjë mësues -
të gjithë kanë lënë gjurmë në shpirtin tim.
Disa më mësuat të ngre dorën kur dyshoja në vete,
të tjerë më mësuat të besoj se zëri im ka rëndësi,
ka peshë, ka dritë.

Sa herë jam ndjerë e vogël,
mjaftonte të ulesha në bankën time,
dhe ndihesha sikur gjithçka do të bëhej mirë.
Sepse ti më kishe mësuar të mos dorëzohem.

Në muret e tua lashë ëndrrat e para,
pyetjet që më digjinin brenda,
dhe ndonjë herë edhe lot të heshtur,
që vetëm këto banka i kuptonin vërtet.

Ti quhesh “Luigj Gurakuqi”,
dhe tani që po largohem,
e kuptoj se sa shumë peshon ky emër —
jo vetëm në histori, por në jetën time.

Ti më dhe më shumë se dije —
më dhe mbështetje kur kisha frikë,
më dhe përqafime në formë buzëqeshjesh të mësueseve,
më dhe miqësi që do të mbeten përjetë.

Kur të më pyesin ku fillova të bëhem kjo që jam,
do të them pa hezituar:
aty ku mësova të dua veten time,
në SH.F.K. “Luigj Gurakuqi” —
shkolla që më mësoi të jem e fortë,
pa harruar të jem e mirë.

Dhe tani që po iki,
jo, nuk them lamtumirë.
Them: faleminderit, shkollë,
që më dhe zemrën për të ëndërruar më tej

NË FLUSKËN E ËNDRRAVE

Shpresë e ardhmërisë- janë ata si yjet që shkëlqejnë, dhe mbushin horizontin duke dëbuar erësirën. Janë ata që nëpërmjet zërit të tyre, të guximshëm dëshmojnë që po i drejtohem i një ardhmërie frymëzuese dhe më tëh bukur. Është inspiruese të shohësh këta të rinj që ndjekin ëndrrat e tyre me guxim dhe vëndosmëri.

Amina Imeri është një nga talentet e reja, e cila po i bashkangjitet artit të fjalës së bukur, poezisë, duke na ftuar në botën e saj të vogël ku ëndrrat janë më të mëdha se frika. Ajo me artin e saj të brishtë prek tematika nga më të ndryshmet, duke na dhënë një pasqyrë më të thellë mbi ndjenjat, emocionet, botën e brendshme unike që ajo e përjeton duke e stolisur nëpër vargje. Ajo flet me plotë emocion për më të dashurit e saj ajo nuk heziton që këtë dashuri ta shpreh edhe përmes vargjeve:

S'e them shpesh, por ndoshta duhet më shpesh:

“Pa të, jeta ime do të ishte bosh”,

Ajo është zemra që rreh për ne,

Nëna ime-dashuria që s'ndryshket kurr.

Ajo i shkruan vargje edhe librit, ku shprehet se udhëton në rrugë të pafundme, kur prek faqet e librit, në një botë të spikatur me magji:

Në faqe fjalët marin jetë,

Tregojnë histori pa fund,

Na çojnë larg,në çdo sekond,

Nga ëndrrat tona bëhen shteg.

Amina Imeri, nëpërmjet vargjeve të saj të spikatura bukur, me emocion me pak art, brishtësi, që i referohet lexuesve paraqitet si një frymëzim për brezin e ri me librin e saj “Bota ime vogël” Ajo premton që nuk do të ndalet këtu, sepse rrugëtimi i saj në artin krijues sapo ka filuar.

Nga Merita Isaki

PËRMBAJTJA

1. "E paharruar, gjithmone"
 2. "Libri, burim i dijes"
 3. "Kush eshte une?"
 4. "Nena-engjelli im i heshtur"
 5. Sa shume rruge plot zgjedhje"
 6. Natyra-qetesia e shpirtit. Dua te jem e lire"
 7. Endrrat ndryshojn"
 8. "Kater peshperima"
 9. "Ato flasin unë jo"
 10. "Kur gaboj"
 11. "Mesuesja ime, drita dhe poezia"
 12. "Ditari im sekret"
 13. "Babi im, Heroi im"
 14. "Adoleshenca"
 15. "Nuk jemi me ne kohen e gurit"
 16. "Lamtumire me ze te dridhur, por me zemer te forte"
 17. "Ne Heshtjen e Lutjes"
 18. "Fjalet tuaja jane plumba"
 19. "Të dua, shkollë që më dhe emër"
- (Poezi për Festën e shkollës sime"



Amina Imeri

Është nxënëse në shkollën fillore komunale “Luigj Gurakuqi” të fshatit Zhelinë, Lindi në vitin në Tetovë, bashkëjeton me familjen jeton në fshatin Zhelin. Kjo është vepra e parë e sajë. Ka marrë

pjesë në disa konkurse lertare të organizuara nga institucione të ndryshme komunale e regjionale. Është nxënëse e shkëlqyshme dhe ardhmëria e potëve të rrinj. Është një vajzë 15-vjeçare me një shpirt të brishtë dhe ëndërrimtar. Muzika është frymëzimi i sajë, sa herë që tingujt ia prekin shpirtin, fjalët i vijnë natyrshëm dhe shndërrohen në poezi. Në ato momente ndihet më e lirë, më e gjallë. E don ngrohtësinë që sjellin fëmijët. Buzëqeshja e sajë shpesh herë është për ta, sepse ata e kujtojnë pafajësinë dhe bukurinë e thjeshtë të jetës. Motoja e jetës së sajë është “Unë besoj në mirësi, në ëndrra dhe në fuqinë e fjalës për të prekur zemra”.



AMINA IMERI

Është nxënëse në shkollën fillore komunale “Luigj Gurakuqi” të fshatit Zhelinë. Lindi në vitin 2010 në Tetovë, bashkëjeton me familjen jeton në fshatin Zhelinë. Kjo është vepra e parë e sajë. Ka marrë pjesë në disa konkurse lertare të organizuara nga institucione të ndryshme komunale e regjionale. Është nxënëse e shkëlqyeshme dhe ardhmëria e poetëve të rinj. Është një vajzë 15-vjeçare me një shpirt të brishtë dhe ëndërrimtar. Muzika është frymëzimi i sajë, sa herë që tingujt ia prekin shpirtin, fjalët i vijnë natyrshëm dhe shndërrohen në poezi. Në ato momente ndihet më e lirë, më e gjallë. E don ngrohtësinë që sjellin fëmijët. Buzëqeshja e sajë shpesh herë është për ta, sepse ata e kujtojnë pafajësinë dhe bukurinë e thjeshtë të jetës. Motoja e jetës së sajë është ”Unë besoj në mirësi, në ëndrra dhe në fuqinë e fjalës për të prekur zemra”.

